



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1370/2 Prot

Gramsh më 06.05.2020

VENDIM  
Nr. 28, datë 30. 04.2020

PER

**PËRDORIMIN E FONDIT TË EMERGJENCAVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.45/2019 ,datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" neni 4, pika 1 dhe 2, neni 6 , neni 7 ; Ligjit Nr.139/2015 ,datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, neni 54 ; VKM Nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore "; VKM Nr. 236, datë 19.03.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 ; Vendimit Nr.33, datë 17.04.2020 "Për miratimin e listës së subjekteve përfitues të asistencës në banesë , në Bashkinë Gramsh" të Komisionit Qëndror për Ofrimin e Asistencës; Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.02 datë: 06.02.2012, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", pika 96 gërma c; Ligjit nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020"; VKB Nr.95, datë 30.12.2019 "Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2020";

**VENDOSI**

- 1-Të miratojë përdorimin e fondit prej **5 515 000 (pesë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë** për përballimin e nevojave ushqimore për familjet në vështirësi ekonomike, sipas Vendimit Nr.33, datë 17.04.2020 "Për miratimin e listës së subjekteve përfitues të asistencës në banesë , në Bashkinë Gramsh" të Komisionit Qëndror për Ofrimin e Asistencës .
- 2-Ky fond të përballohet nga buxheti i Bashkisë Gramsh për vitin 2020 për emergjencat civile.
- 3-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Gramsh.
- 4-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë  
Endri Mema

Konc. Dakt. E. Mema  
Miratoi. G. Lena  
Konfirmoi. G. Lena  
Dosja \_\_\_\_\_  
Afati \_\_\_\_\_



Kryetari i Këshillit të Bashkisë  
Greta Lena